



ENTI RREGULLATOR I ENERGIJË

BORDI

VENDIM

Nr. 113, Datë 09.07.2020

“MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
RREGULLORES MBI PROCEDURAT E NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK TË
AKTEVE TË MIRATUARA NGA ENTI RREGULLATOR I ENERGIJË”**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 16 dhe 18 të ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, , nenit 15 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 03.09.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 09.07.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me Nr. 78/7 prot datë 30.06.2020 e përgatitur nga Drejtoria e Çështjeve Ligjore, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë”,

Konstatoi se:

- Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve që krijohen në një proces të konsultimit publik, transparent, gjithëpërfshirës, të realizuar në kohë dhe efektiv ndërmjet organeve publike qendrore dhe vendore dhe palëve të interesuara, në procesin e vendimmarrjes së projekt akteve si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politikave me interes të lartë publik.
- Ligji nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, parashikon në nenin 18 se *ERE miraton rregulloren për konsultimet publike, ku për aq sa është e mundur merr në konsideratë procedurat dhe afatet e legjislacionit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik, ku, ndër të tjera, parashikohen kushtet dhe procedurat, paraqitja e kërkesës formale dhe shpallja publike e informacionit.*
- Rregullorja e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE, e miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 03.09.2016, ka një sërë parashikimesh ligjore që lidhen me përmbushjen e detyrimit të ERE për konsultimin publik të akteve rregullatore të cilat miraton për kompetencë.

- Një detyrim të kësaj natyre, ERE e ka zbatuar në mënyrë rigoroze përgjatë gjithë veprimtarisë së saj, jo vetëm si detyrim i parashikuar në ligjin sipërcituar, por mbi të gjitha si një aspekt shumë i rëndësishëm i ushtrimit të kompetencave funksionale e detyrave të sanksionuara në ligjin nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar.
- Në mbështetje të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, Ligjin nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe ligjin nr.7/2017 “Mbi nxitjen e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE që nga momenti i hyrjes në fuqi të këtyre ligjeve ka miratuar rreth 90 akte nënligjore të llojit rregullore, metodologji, marrëveshje tip etj, e riparë me kërkesë të palëve të interesit këto akte në procedura që kalojnë përmes të njëjtave faza që kalon vetë miratimi i aktit, në rreth 40 praktika të tjera.
- Rregullorja e propozuar për miratim sjell detajim të procedurave dhe afateve për përmbushjen e detyrimit të organeve publike për konsultim publik.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë.
2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për Vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI